



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 309/ 2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Nenad Lazić dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), në seancën e panelit të mbajtur me 11.06.2014, mori këtë:

## V E N D I M

**HIDHET** si e palejuar ankesa e subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje (LVV)

### A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 06.06.2014 ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV në të cilin pretendon se me datën 07.06.2014 aktivistet e LVV-së nga Qendra në Rahovec diku rreth orës 14:00 kanë vërejtur se mbi rrugë publike ishte i vendosur baneri i kandidatëve për deputet të AAK-së, Ramush Haradinaj, Smajl Latifi, Luan Jaha dhe Florije Boshnjaku, veprime këto që sipas parashtruesit të ankesës janë në kundërshtim me dispozita ligjore të LZP-së

PZAP-i, pas shqyrtimit të lejshmërisë së ankesës gjeti se:

### Ankesa është e palejuar

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi ankesën në fjalë gjeti se për këtë çështje PZAP-i ka vendosur më parë me vendimin e tij Anr. 183/2014 të datës 08.06.2014. Andaj meqenëse për njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli vendosi që ankesën në fjalë ta hudhë si të palejuar.

PZAP-i, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it ,si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 309/2014 më datën 11.06.2014.

Kryesuesi i Panelit  
Muharrem Shala



### *Këshillë Juridike:*

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*